

KOSOVARJA

Ballina: Vera Qollaku

Popullin s'e
mbajnë këmbët,
politikanët
shalojnë atin

Ku humbi
kryetari
Legjendar

Si jetojnë
5000 shqiptarë
të Ukrainës

Vera Qollaku,
*shqiptarja e suksesshme në Zvicër
që e ka mision të bukurën*

Në fshat – 30 vjet
pa asnjë dasmë

Rrëfime:
A jetohet me
homoseksualin

Pjella e keqe
ta prishë
shtëpinë

Pse njohjet
e të njohurve tanë
përfundojnë
me ndarje

UB
UNION BUSINESS
ALBANISCH & DEUTSCH

DINO
CERAMICHE

Shkabaj
FISH BELL

MOLLA

Shkenda Dajana
COCO BAKERY

Manaderm

DENTFIX

allure

HELPER
GENÈVE

REMOS

SHERWOOD

BREZOVICA

CIMA





Në Kosovën shtet...

Popullin s'e mbajnë këmbët, politikanët shalojnë atin!

Populli është lodhur, sidomos kohëve të fundit kur shtrenjtimi i gjërave më elementare për jetë ka arritur kulmin e durimit. Populli, për nga lodhja, më ngjan në rastin e Sadikut të Anamoravës. Sadiku ishte shakaxhi dhe shkonte në dasma odë më odë. E, në pyetjet që ia bënin, gjithmonë kishte përgjigje...

Në një dasmë, e cila bëhej në pranverë, e pyesin:

"A munde t'i nxjerrësh kuajt gjallë në Shëngjergj, o Dik?", kështu e thërrisnin shkurt Sadikun.

"Mirë i kam: Njëri kalë gati ngrihet vetë në këmbë, e tjetrit pak me i ndihmua çohet..." Kështu është edhe me popullin tonë: i lodhur e i dërmuar tej mase, sidomos kohëve të fundit, kur gjërat më elementare për jetë janë shtrenjtuar shumë, kanë arritur kulmin...

A MUNDET NJERIU TË SHARROJË EDHE KUR MBAN SYZE?

Njëri prej burrave e kishte pyetur Dikun, demek Sadikun: Pse lodhen sytë?

Burri pleqnar i ishte përgjigjur që të merr syze në mënyrë që t'i mbrojë sytë... Por, edhe me syze mund të sharrosh, ishte përgjigjur ai.

Lehtë është të flasim si i ka ndodhur atij që ka marr syze dhe ta krahasojmë me dialogun Prishtinë-Beograd. Shkon një plak te mjeku dhe merr syze zmadhuese. Me syze niset ta kalojë lumin në Nerodime, lum me ujë të kthjellët që vjen nga bjeshkët e Jezercit.

Shikon e shikon ku ta hedhë këmbën dhe i duket se kishte vend të mjaftueshëm mbi një gur, e që syzet zmadhuese ia kishin zmadhuar shumë. Lëshon këmbën mbi guri, duke menduar se është i madh dhe sharron deri në kërdhokull. Në ato çaste i kujtohen fjalët e Dikut: "Mund të sharrosh edhe me syze!"

KOSOVA ME TË VETEN, SERBIA ME TË VETEN!

Kështu po ndodh edhe me dialogun Kosovë-Serbi. Kosova me Kushtetutën e vet, Serbia me të veten! Kujt t'i besohet? Kur e dëgjon Vuçiçin sheh se ka humbur Kosova. E, kur e dëgjon Albin Kurtin, thua: Serbia do të mbetet vetëm me Pashalëkun e Beogradit...

Por, një gjë është e sigurt: Dikush do të fitojë e dikush do të humbë...

Sidoqoftë, në këtë fillim-pranverë, populli, nga shtrenjtimit e çdo ditshme, është lodhur tej mase. E, të mos flas për pensionistët, sepse nuk i bën kush as për hesap! Ndërkaq, për politikanët, deputetët dhe të tjerët që merren me politikë, kurrë s'ka qenë më mirë...

Selim Rama

Në ballinë:
Vera Qollaku



Vera Qollaku, shqiptarja e suksesshme në Zvicër që e ka mision të bukurën

Vera Qollaku është zonja e suksesshme e fushës së bukurisë, që kryen shumë shërbime profesionale me pasion, dashuri dhe delikatesë të madhe.

Vera prej vitesh e jeton ëndrrën e dikurshme për të qenë kjo që është sot.

Për punën dhe të arriturat flet me zemër dhe thotë se në rrugën e suksesit nuk mund ta ndalë asgjë. Beautynailsvera.ch është brendi dhe firma e saj me emër në Zvicër.

Për historinë e Verës shkruajmë në “Kosovare”...

Verë, njiheni si femër e suksesshme. Na fol pak për storien tënde të suksesit?

- Para shumë vitesh kam filluar të punoj fillimisht në shtëpinë time, sepse isha nënë e tre fëmijëve, kurse dëshirën për punë e kisha të madhe. Por, nuk doja assesi që familja dhe fëmijët e mi të mbeteshin anash. Tani kam sallonin tim në Cyrih të Zvicrës, që është shtëpia ime e dytë, e ku klientet e mija ndihen tejet komod me shërbimet që ofrohen dhe realizohen aty.

Çfarë të ka ndihmuar të jesh kjo që je sot?

- Më ka ndihmuar shumë vullneti dhe dëshira e madhe për t'i bërë vajzat, nënat, gratë, që të duken sa më të bukura dhe të ndihen të lumtura me pamjen e tyre. Ky është mision...

Sa sfiduese ka qenë rruga drejt të pasurit sukses?

- E vërteta është se nuk mund të them që ka qenë e lehtë dhe pa sfida. Asnjëherë nuk jam ndal drejt realizimit personal e profesional dhe këtë nuk do ta bëjë kurrë, pasi profesionin tim e

kam në zemër. Dhe, kur diçka e do me zemër, atëherë nuk të ndalë gjë...

Kush është personi që të ka bërë të besosh që ti mund t'ia dalësh?

- Lirisht mund të them se vetvetja, pasi një njeri që ka vetëbesim në vete dhe arritjen e qëllimeve, kurrë nuk do t'i mungojë sukcesi, madje nëse lufton fort do ta ketë atë gjithmonë të garantuar.

Tingëllon edhe si mesazh për femrat dhe njerëzit në përgjithësi, apo?

- Po, sepse kjo është e vërteta e madhe e rrugës sfiduese për t'ia dalë mbanë dhe për t'u përmbushur në të gjitha aspektet. Njerëzit duhet ta duan dhe të luftojnë fort për gjërat që duan t'i arrijnë në jetë.

Verë, a mund të na flasësh për sallonin dhe shërbimet që ofron?

- Në beautynailsvera.ch ofrohen shërbime të ndryshme profesionale nga fusha e bukurisë, si microblading nga PhiAcademy, henna brows, browslifting, wimpernverlängerung prej 1:1 teknik deri te rusian volume, thonj, wimpernlifting, hairextensions,



pedikyr&spa, si dhe trajnime për thonj dhe për qerpikë.

Ju trajnioni edhe studente, a?

- Mbj kurse për qerpikë, që nga kurset bazë e deri tek volumi. Gjithashtu, mbaj kurse intensive për thonj. Studentet të cilat certifikohen nga beautynailsvera.ch kanë mundësinë tre muaj të praktikojnë te studioja ime, sepse synimi im është arritja dhe suksesi maksimal i studenteve që aftësohen te unë.

Ju, personalisht, ku jeni shkolluar e trajnuar?

- Jam shkolluar dhe diplomuar në Zvicër, por edhe jashtë vendit. Vazhdoj të marrë pjesë në trajnime të ndryshme, sepse faza e të mësuarit të teknikave të reja dhe avancimit profesional nuk mbaron asnjëherë.

Keni edhe produktin tuaj të personalizuar, që është për mirëmbajtjen e qerpikëve? Ç'thua për këtë?

- Kam produktin tim të parin dhe të vetmin për momentin. Quhet "Beautynailsvera Eyelash foam cleanser", i cili është për mirëmbajtjen e qerpikëve extensions. Në vijim pritet të vijjnë edhe projekte të tjera, që për mo-

mentin po i mbaj sekret.

Risia e fundit në beautynailsvera.ch?

- Është Microblading, që më ka hyrë shumë në zemër dhe e bëj me kënaqësi të veçantë. Për Microblading kam përfunduar akademinë më të madhe në botë për këtë drejtim, PhiAcademy.

Je shqiptare e suksesshme larg vendlindjes. E ndjen si sukses të madh këtë gjë?

- E rëndësishme është që çdo gjë që e kam arritur, ka qenë me shumë mund, përkushtim dhe dashuri. Nuk ka rëndësi vendi. Njëjtë do të veproja edhe sikur të isha në vendlindje...

Dukeni shumë bukur. Sa investoni në paraqitjen e jashtme?

- Pasi i takoj botës së të bukurës, e kuptueshme që nuk e lë veten pas dore. Ne, profesionistet e kësaj fushe, jemi pasqyra e rinisë, andaj përpiqem të jem shembull i mirë për vajzat dhe femrat kudo që ndodhen.

Pasioni juaj?


- Puna, kuzhina, shëtitjet.

Vendi që gjithmonë kthehesh me qejf?

- Aty ku është familja e gjej qetësinë...

N. N.

Cili ishte Testamenti në burg i Ukshin Hotit?



E motra e Ukshin Hotit, Myrvetja, që në Kosovë dhe Shqipëri njihet si një Doruntinë, tregon me lot në sy se në takimin e fundit në burgun e Istogut (kurrë nuk u panë më), i vëllai, Ukshin Hoti, i ka thënë:
“Motër! Nuk i dihet fatit tim. Po fillon çlirimi i Kosovës nga NATO-ja dhe UÇK-ja. S’dihet se çfarë bën UDB-a me mua. Ka nisur t’u derdhet kupa e durimit. Po ta lë si testament: Nëse unë vdes, gjithçka që kam shkruar brenda kudhrës së burgjeve të botohet.
Kur i kam radhitur dhimbjet e mija në letër, e dija se do të bëheshin përpjekje për t’më censuruar. Libri i jetës të dalë i plot në dritë. Dorëshkrimet e ferrit edhe ato më të trishtat, në të gjitha ka-

het, sheshazi të merren vesh pa kufizim”.

PSE U VETËFLIJUA UKSHIN HOTI?

Afrim Hoti, i vëllai i Ukshin Hotit, bën portretin dhe narrativën e jetës së vëllait, që nuk kishte qenë petal trëndafili.
Ukshin Hoti i pati të gjitha mundësitë të qëndronte në Harvard e Boston të SHBA-ve, ku dha dhe leksione. Gjithashtu, pati miq në Amerikë, të cilët i thanë që të qëndronte atje. Thuhet se Ukshin Hoti në Harvard është takuar edhe me Presidentin e Amerikës Xhimi Karter.
Por, filozofin e thërriste çështja e madhe e Kosovës, që ishte nën pushtimin serb.

Edhe kur u kthye në Kosovë dhe armiqtë e izoluan, iu krijuan të gjitha mundësitë që të mërgonte në Gjermani, ashtu si i vëllai Afrimi. Me marifet ja rregulluan dhe pasaportat. Por, Ukshin Hoti nuk lëvizi nga istikami. E dinte se do të vetëflijohej. E ndjente.

Ja çfarë shkruan me dorën e tij:
“Ka momente të tilla kur vdekja është më e lehtë sesa lojë – lufta me jetën, por vdekja si mundje dhe jo si humbje. E provokova tri herë, por nuk më deshë. Herën e katërt nuk desha ta provokoja vrasjen, por e dija se mund të vinte dhe isha indiferent ndaj saj”.

BRENGA E VËLLAIT, AFRIM HOTIT

I vëllai, Afrim Hoti, ka një brengë. Ditën që Ukshin Hoti ka dalë nga burgu i Istogut, më 16 maj 1999, ai ka pasur në dorë tri qese të zeza. Ish-të burgosurit e qelisë tregojnë se një qese filozofi e ka pasur të mbushur me fletore. Në një nga qeset ka qenë dhe një fotografi, të cilën Ukshin Hoti ia bën në burg një javë para se ta zhduknin. Ka shumë gojëdhëna për këtë fotografi. Foton ia bëri Ukshin Hoti një serb, që ishte edhe fotograf i burgut. Porosia e Ukshin Hotit kishte qenë që ta kishte një foto me vete kur të dilte nga burgu. Çoç parandjeu.
E rëndësishme është se në një nga tri qeset që ka pasur në duar Ukshin Hoti, kur ka dalë nga burgu më 16 maj 1999, ka qenë edhe një foto e bërë brenda burgut.

Sefer Pasha

Pronar dhe botues:

Gani DILLI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILLI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Rilinda Krasniqi

Ardita Dili

Dizajni:

Labinot Bërbotovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com

CILËT NJERËZ NDEROHEN NË KOSOVË?

Në Kosovë, nëse je i papunë, je i humbur dhe i pashpresë. Nëse je punëtor dhe merr dyqind euro në muaj, mjek a inxhinier dhe merr pesëqind euro në muaj, je luftëtar i mbijetesës. Do jesh i parespektuar, i injoruar, i fyer.

Por, nëse je hajn i rangut të lartë, nëse bën reket në nivelin shtetëror e fitim padjersë, atëherë je njeri i suksesit! Për ta Kosova është vend i afirmimit, ke mundësi të ndërtosh pallate e objekte të papara në këto troje...

Do të jesh i respektuar, i lavdëruar, i nderuar!

*

Shpesh na ka rënë të dëgjojmë: E vërteta është e hidhur!

E vërteta nuk është as e hidhur, as e ëmbël, as e bardhë, as e zezë...

E vërteta është fillimi dhe fundi, tërësia vetë.

Po, për kë është e vërteta e hidhur?

Për mashtruesin. Për mjeranin që e ka mashtruar veten me iluzione se është

dikush dhe kur ia thua të vërtetën bëhet helm e vrer.

E vërteta është e hidhur për gënjeshtarin, për panjeriun, për hiçin.

E vërteta është e vërtetë...

*

Është shumë e çuditshme se njerëzit që nuk dinë se kush janë përpiqen të jenë dikush. Ata nuk e dinë se kush janë, ata janë të pa njoftuar me qenien e tyre, por kanë qëllim të bëhen dikush.

E, të tillët nuk janë të paktë në përditshmërinë tonë.

Pakkush po bëhet dikush...

*

Një djalosh u shpallë njeriu më i mençur. E kishte koeficientin më të lartë të inteligjencës në botë.

E pyetën gazetaret:

"Prej cilave sisteme filozofike mëson?"

"Rri me njerëz!", përgjigjet djaloshi.

Gani Dili



Nisem për në Gadime e shkoj në Lipjan!

Si nënë e vakive që jam, dje, teksa dua ta blej në treg një gjel, e që nuk gjendet asnjë as për ilaç, kthehem për në shtëpi, pra rrugës kah kam ardhur, por me mua është çudi: Nisem për në Gadime e shkoj në Lipjan!

Posa arrij në "Veternik", një vajzë ngrit dorën që ta marr me veturë. Them me vete: ta ndali, por ishalla nuk është si ajo që një ditë e mora e nuk dinte as vetë se ku shkonte...

Dhe, posa e ndala veturën, futet brenda pa më pyetur as ku shkoj dhe a do e marrë me veturë...

"Si je? A je mirë? Si e ke gruan, fëmijët? Si janë në shtëpi?", më thotë.

E shikoj në sy, mos po del e familjes...

"Mirë jemi. Po ti, a më njeh mua, a?! A e di

që jam i martuar dhe kam fëmijë, a?!"

"Jo, nuk po të njoh. Por, në moshën tënde nuk mund të jetë njeriu pa grua, pa fëmijë!", ma ktheu.

"E, pse nuk mund të jem pa grua? Mund të jem i ndarë. Edhe pa fëmijë mund të jem, se, po qe se jam ndarë nga gruaja, fëmijët shkojnë me nënën", ia kthej unë.

ISHALLA JE NDARË NGA GRUAJA DHE E GJEN TJETRËN MË TË MIRË!

"Po, mirë e ke. Por, nëse je ndarë nga gruaja ki shansin me u martua edhe një herë. Ndoshta e gjen edhe më të mirë se ajo që e ke pasur", ma ktheu në shpejtësi.

"E ti, sa vjeçe je?", i them.

"Po, ku pyetet femra për moshë, o burrë?!", shpejt ma ktheu ajo.

"Mirë e ke, por ti nuk po më dukesh se ke hyrë në rend të femrave, sepse qenke e re!"

"Çfarë e re, allahile! Por, pash Zotin, a po më dërgon në Lipjan se e kam një shoqe të bukur atje?", ma ktheu në vend të përgjigjes.

"A zbret te QMI-a se unë nuk shkoj në Lipjan", i them, meqë gati arritëm afër udhëkryqit për në Lipjan.

"Zbres, pse jo! Por, a mundesh me më lënë

në rrugë, a?! Bile, kur të shkojmë në Lipjan ma blen një pako cigare, se sot nuk e kam pi asnjë?", thotë pa fije turpi.

NDOSHTA EDHE VAJZA IME BREDH RRUGËVE...

Eh, bela, po kah më erdhe, them me vete... Dhe, përnjëherë më silltet në mendje se, ndoshta, edhe vajza ime është diku rrugëve, duke i ndalur veturat si kjo, apo duke u lypur t'i blejnë cigare.

Dhe, kur arritëm në qendër të Lipjanit, shyqyr Zotit, doli nga vetura se kushedi çka do të ndodhte me të...

Për një çast m'u kujtua Polonia. Koha kur ne shkonim atje, shumica për vajza të reja...

E tash, në Kosovë, vijnë njerëz nga vende të ndryshme të Evropës, me punë e pa punë dhe, me siguri, kënaqen me femrat tona, sepse nuk thonë kot se asgjë nuk mbetet për dynjanë tjetër...

Kjo po ndodh edhe me arabët, të cilët dikur në Poloni bënin kërdi me femra të reja e të bukura, duke u hedhur polakeve në trupin e tyre të njomë dollarë amerikanë. E, tash evropianët shkojnë në Dubai si në shtëpitë e tyre dhe e dinë ata se çka bëjnë me femrat arabe atje...

Pse kolegët e Redaksisë nuk flasin për dashuri, por vetëm për politikë?

Ditë më parë pash një ëndërr të veçantë. Hyra në lumin Bistrica të Rugovës. Por, nuk e kisha hetuar se një vizitor më filmonte me kamerë, kinse unë isha kampion në not...

Kur u zgjova në mëngjes, desha t'ia komentoj ëndrrën gruas, se si isha bërë kampion në lumin Bistrica. Por, tamam desha ta qes fjalën, më ra ndërmend nëna, duke ia shpjeguar babait ëndrrën e natës. "Ah, grua, edhe ëndrrat i ke të budallenjve!", ia ktheu ai.

Dhe, nga frika se gruaja do më thotë mu atë që babai ia tha nënës sime, hoqa dorë nga të treguarit e ëndrrës.

Eh, Sokol, i them vetes, çka do që nisë të bësh, ky djalli që e ke në të djathtë, ta pret me të shpejtë...

Nisem të shkoj në punë dhe mendoj se ku do i del tymi ëndrrës. Derisa hyj në veturë më kujtohet se e kam harruar telefonin në shtëpi. Kthehem ta marrë dhe në kokë më bie një qese bërlllok dhe bluza më bëhet si me pas dal prej pusi...

Por, në çast më kujtohet se po t'më binte ndonjë mjet i fortë nga lartësia, do të ndodhesha në spital, andaj më mirë që përfundova me bluzën bërë pis.

I TREGOVA GRUAS TËNDE SE KEMI QENË DASHNORË!

Pasi e marr telefonin, si e porositur më thërret një femër.

"Hej, i tregova gruas tënde se ne dikur kemi qenë dashnorë!", më thotë ajo dhe ma mbyll telefonin.

Hopa, kjo qenka porosia e ëndrrës në lumin Bistrica, them me vete. Po, kush thotë se nuk del ëndrra?! Tash do kërcet ki- ameti... A thua, kush ishte femra që kishte folur me time grua?!

Dhe, pasdite, kur kthehem në shtëpi, shoh se gruaja është ndërruar e rregulluar si është më së miri...

"Eh, tash, vajhalli për mua!", them ngadalë, por ajo bëhet sikur nuk më dëgjoji.

Pas pak, sikur gjej zgjidhje. Do i them gruas se unë, Sokol Murturi, nëna e va-

kive, ose do të jetojmë në besim të plotë ose do të ndahemi!

Dhe, kur ia them këto fjalë gruas, ajo jo që kundërshtoi, por e miratoi menjëherë ndarjen...

"Më mirë ndahemi, sesa të lodrosh poshtë e lart me dashnoret tua!", ma ktheu me plot pezm.

Eh, Sokol burri, po bërlllok e bëre, them në vete. Kurrënjëherë nuk dite me dalë nga kriza, por vetëm sa u thellove në të, madje thellë e më thellë...

PSE ME GRUAN NUK FLASË PËR UKRAINËN?

Dhe, kur s'më mbet më çka të flasë me gruan, më shkoi mendja te Ukraina dhe lufta me Rusinë.

Eh, këtu kam çka të flasë dhe me kë të flasë. I kam ata të Redaksisë që në kafene flasin vetëm për politikë...

S. M.

Pse ra karriera e Dafina Zeqirit?

Sado që dha këngë të reja, Dafina Zeqiri u pa se nuk mundi ta mbajë primatin që dikur e kishte në opinion. Karriera e saj, sipas shumë kujt, është në rënie. Dhe, për këtë duket se sherr ishte jeta e saj private. Lidhjet e shumta, të njëpasnjëshme të dashurisë, si dhe futja në zënka mes ish-të dashurve, bën që Dafin ta quajnë edhe me pseudonimin "Nusja e estradës".

Jo vetëm kaq, këngëtarja pat probleme edhe me kompanitë që ishin të autorizuar për të publikuar këngët e saj në "Youtube" dhe për këtë disa herë klipet e saj janë fshirë nga ky kanal muzikor. Si për inati, Dafinës iu zbulua edhe një incizim privat, ku ajo dëgjohej duke folur keq për kolegët e saj këngëtare. Ndërkohë, Dafina filloi të acarohet edhe më gazetarë, t'i kërcënojë, madje edhe t'u kushtojë këngë, duke harruar se ishin gazetarët dhe mediet ata që e përkrahen atëherë kur ajo kishte më së shumti nevojë.



Politikani i dikurshëm, Kryetari Legjendar i Partisë së Fortë, Visar Arifaj, sozinë e kishte në Turqi. Shqiptarët, që e shikonin "RTV21"-shin, aso kohe, kur ai ishte në hovin për t'u bërë deputet, e shohnin në

serialin turk "Karaday", sepse i ngjasonte aktorit turk Olgun Tokar. Sidoqoftë, Visar Arifaj arriti të bëhej anëtar i Asamblesë Komunale të Prishtinës, ndërsa edhe në Asamble vazhdoi


Ku humbi kryetari Legjendar?

me politikën e njëjtë, të ironizimit të gjithçkaje. Shtrohet pyetja: Hë, ku është tash, ish-kryetari Legjendar, meqë edhe partia i është shuar qëmoti?

remos® KA PUNË PËR TY!



Çka ne po kërkojmë është: **Pizzamen, Kuzhinier, Barista, Kamarier**



Aplikuesit duhet të kenë njohuri të gjuhës
Gjermane dhe Angleze

Vendndodhja:
**Frankfurt, Këln, Koblenz, Wiesbaden,
Westerwald, dhe Urmitz.**

Na kontaktoni në info@remos-restaurants.de

24 vjet të masakrës së Prekazit...



Ku ndodhet Shqipja, bija e komandantit Adem Jashari?

Shqipe Jashari, vajza e komandantit legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jasharit, është e martuar me avokatin Xhevdet Krasniqin dhe i kanë katër fëmijë.

Ditë më parë qe 24-vjetori i Betejës së Jasharëve në Prekaz, kundër regjimit okupator serb. Përvjetorët shkojnë e vijnë. Kujtimi për më të dashurit rikthen momente të rënda e të lavdishme të asaj kohe, me qëllim për t'i kujtuar të gjithë ata që dhanë më të shtrenjtën, që dhanë gjakun e tyre për lirinë e këtij vendi, edhe pse ende nuk shkuan në vend idealet e tyre. Fotoja e Komandantit Legjendar,

Adem Jasharit, që tanimë është e pranishme në qindra-mijëra shtëpi të familjeve liridashëse shqiptare, duket se më së miri zë vend në ballë të oxhakut të shtëpisë së Shqipe Jasharit. Fotografia e legjendarit qëndron përballë edhe në zyrën ku punon Shqipja. Shqipja është juriste dhe punon administratore në Shkollën 12-vjeçare "Arsimi i Shqipërisë" në

Prishtinë. Jasharët mbijetuan falë përkushtimit dhe sakrificës për liri e parvarësi, falë besimit në fitore... Mesazhi i familjes Jashari është që çdo përvjetor ta festojmë ashtu si na ka hije dhe ashtu si e meritojnë dëshmorët. Sepse, sa herë vijnë përvjetorët e dëshmorëve na japin forcë, shpresë, besim në frytet e fitores dhe shtytje për fitore të reja.



Vendbanimi i bukur – Piqeras

30 vjet pa asnjë dasmë!

*Në fshatin
Piqeras të Sa-
randës, dasma
e fundit ishte
para 30 vjetësh!
Pse s'ka marte-
sa tash?*

Piqerasi është një vendbanim i bukur bregdetar në rrethinën e Sarandës. Fshati ndodhet buzë

rrugës së bukur bregdetare Sarandë-Vlorë.

Por, e keqja e këtij fshati, si dhe e shumë vendbanimeve të tjera të kësaj ane, është se njerëzit kanë migruar, duke marrë udhën për në Greqi.

Të moshuarit, e që kanë mbetur në këto troje, do të donin t'i kishin fëmijët pranë, por i kanë këshilluar të mos kthehen. Dyert e mbyllura me dry janë panorama e fshatit Piqeras, ku sot kanë mbetur vetëm 20 shtëpi.

Sidoqoftë, emigrimi mbetet një nga problemet më të mëdha në

fshatrat e jugut, ku shumë nga të moshuarit e kalojnë pensionin të vetëm, me fëmijët e tyre që jetojnë shumë larg tyre.

E, duke mos pasur të rinj në këto vise, natyrisht, mungojnë edhe martesat, mungojnë edhe lindjet. Është fenomen i rrallë në këto zona kur dëgjohet për lindje, është një gjë e rrallë për gjithë zonën. Por, si kjo ndodhi në fshatin Piqeras, dëgjon në çdo cep të Shqipërisë, nga veriu në jug. Madje, në shumë raste djemtë e rinj detyrohen të marrin nuse nga zona dhe krahina shumë larg zonës së tyre.



Shqiptarë të Ukrainës pranë bustit të Skënderbeut në fshatin Karakurt

Si jetojnë 5 mijë shqiptarë të Ukrainës?

300 vjet të shqiptarëve në Ukrainë. Flasin toskërishten e vjetër, ruajnë kostumet popullore qindravjeçar, festojnë Shën Gjergjin në kujtim të Gjergj Kastriotit...

Ngjarjet e fundit në Ukrainë janë prej ditësh në faqet e para të mediave botërore. Konflikti mes këtyre dy vendeve, shkaku i Krimesë (gadishull ukrainas me shumicë ruse), duket se nuk po gjen zgjidhje, andaj edhe lufta vazhdon.

Sidoqoftë, sot në Ukrainë jetojnë 5 mijë shqiptarë, të ardhur nga Shqipëria, kryesisht nga Korça e Pogradeci, 300 vjet më parë, si pasojë e përndjekjes osmane. Studiuesi kosovar, Baki Ymeri, por edhe të tjerë shqiptarë që kanë hulumtuar mbi historinë e këtij komuniteti, pohojnë se rreth 5000 banorë të këtij rajoni e identifikojnë veten si shqiptarë.

Gjuha që flitet sot në to është një përzierje e shqipes toske me rusishten, ndërsa zakonet, folklori dhe veshjet janë të trashëguara nga stërgjyshërit e tyre.

CILI VENDBANIM KA MË SË SHUMTI SHQIPTARË?

Vendbanimi Karakurti ka rreth 2.700 banorë dhe 80 për qind e tyre janë me origjinë shqiptare, të tjerët janë rumunë dhe bullgarë.

Sidoqoftë, shumë pak është shkruar dhe shumë pak është bërë për këta shqiptarë, që prej më shumë se 300 vjetësh jetojnë larg vendlindjes, mes 48 milionë ukrainasve.

Në vitin 2006, Shoqata "Lidhja e Shqiptarëve në Botë", mori nismën e dokumentimit të realitetit dhe mbijetesës së komunitetit shqiptar të Ukrainës.

Agim Xhemali, i dërguari i saj, gjatë vizitës në Odesë, mbeti i befasuar nga fanatizmi me të cilin shqiptarët kishin ruajtur gjuhën dhe zakonet e vjetra të paraardhësve.

"Shqiptarët e Ukrainës flasin në masën 70 për qind shqip dhe pjesën tjetër e plotësojnë me fjalë ruse", shprehet ai.

TRASHËGIMIA E SË SHKUARËS

Shqiptarët e Odesës i kanë ruajtur zakonet e të parëve, një fakt i tillë verifikohet kur hyn në familjet që banojnë këtu, në dasmat, në punimet dekorative me dru etj. Ishte kjo arsyeja që kur për herë të parë hyri në oborrin e familjes një vizitor, si Agim Xhemali, e zonja e shtëpisë e priti me bukë të bërë vetë, çka nënkupton traditën e vjetër shqiptare të mikpritjes. Popullsia shqiptare e këtyre fshatrave i ruan traditat e veta, ka folklorin gojor dhe koreografik, ndërsa gratë tjerrin qilima me motive shqiptare.

PHI ♀ LINGS
ARBNORE GEGOLLAJ



 /StudioLolaOfficial

 /phi.arbnoregegollaj

Adresa: Përballë Komunës Malishevë ; Kontakti: +383 49 573 896;

Në cilin fshat të Kosovës i vdekuri rri mbi kalë?

Tri ngjarje më kanë mbetur në kujtesë dhe nuk më largohen dot. Rasti i parë ka të bëjë me Kllokotin e Vitisë, i dyti me vizitën që i bëra motrës disa vjet pas vdekjes së burrit, si Konstandini që ia kishte dhënë besën Gerantinës dhe, i treti, në vitin 1996, serbët e rrihnin një shqiptar në Slllovi të Lipjanit, para shitores së tij, pse u kishte folur shqip e jo serbisht!

Një ditë, teksa udhëtoja nga Ferizaj për në Kllokot të Vitisë, pranë një restoranti e ndala veturën. “Të hyjmë në restorant dhe pimë nga një kafë”, i them gruas. Dhe, kur hymë në restorant tollovi sa të duash... “Edhe pse kohë krize restoranti plot me mysafirë!”, më thotë gruaja. Por, as kjo nuk ishte tema e këtij shkrimi. Tri ngjarje e përbëjnë temën që ia vlen të kujtohet...

NGJARJA E PARË

Në vitin 1989, teksa kaloja me veturë, në Kllokot më ndalën policia e asaj kohe. “Ku shkon?”, më pyeti njëri prej tyre, pasi m’u ofrua te dritarja e veturës. Ishte ora 20 e mbrëmjes. U thashë se

po shkoja në Gjilan. “Pse po shkon në këtë kohë?”, më pyeti tjetri. “Shkoj për aventura”, i thashë. “Ti nuk e paske syrin e aventurave!”, më tha i treti dhe më urdhëroi të dilja nga vetura. Pas dola nga vetura më mbështetën për veture dhe filluan t’me kontrollojnë... Dhe, në atë moment më erdhi të qeshja. “Pse qesh?”, më pyeti polici që më kontrollonte. “Qeshi se m’u kujtua gruaja. Po të ishte ajo me mua edhe asaj do ia shtinin duart nëpër trup si mua!”, i thashë kinse me shaka. Pas pak, një polic, e që dukej plotësisht i dehur, më tha:

“Unë po të njoh ty në bazë të emrit në letërnjoftim. Por, që të jemi të sigurt po e verifikojmë nëpërmjet qendrës”. Dhe, teksa po prisja i mbështetur për veture, i bëra pyetje vetes: A nuk kishe çka t’u thoshe tjetër o Sokol pos që po shkoje në Gjilan për aventura, a?! O gojë, çka fole! Pastaj, m’u kujtua në shpejtësi se si një i uritur, e që kishte shkuar mysafir, kur i kishin thënë: “Eja ulu në sofër!”, ai, duke menduar se i zoti i shtëpisë do ta luste pafundësisht, i thotë: “Jo, kam ngrënë”. E, kur erdhi pitja në sofër, mysafiri i tha vetes: “U thafsh oj gojë pse fole!”. Pas disa minutash m’i sollën dokumentet dhe më thanë: “Ik nga këtu dhe mos u paraqit këndeje pari se këtu është Serbi!”.

NGJARJA E DYTË

Ngjarja e dytë ndodhi më 1994. Isha kthyer nga Austria, ku kisha kryer disa punë në klubet shqiptare. Shkova ta vizitoja motrën, së cilës vite më parë i kishte vdekur burri dhe e kishte lënë me dy fëmijë të vegjël. Nuk kishte grim në fytyrë, nuk ishte e veshur mirë, jo se nuk kishte, por ishte e demoralizuar nga vdekja e burrit. U përqaftuam përmallshëm si vëllai me motrën. Nuk kisha fuqi t'i thosha asgjë, madje as ta ngushëlloja... Isha i preokupuar me gjendjen e saj, si në kohën e Konstandinit dhe Gerantinës, kur motra mallkonte vëllanë pse nuk e kishte mbajtur besën të shkonte ta merrte në gjini. Konstandini kishte vdekur nga mortaja, kurse e motra nuk e dinte. Nëna kishte mbetur vetëm dhe fliste me qyqen, e cila vajtonte mbi degën e tharë të lisit në oborr. Kur nëna e kishte përmendur emrin e të birit të vdekur, ai ishte ngritur nga varri dhe ishte nisur të shkonte te Gerantina. Rrugës për te motra, dy zogj mbi një degë druri, i thonë njëri-tjetrit: "A e sheh si rri i vdekuri mbi kalë?!". Nuk dija, në fakt, a më kishte pyetur motra se a doja kafe a jo, sepse isha tretur me ngjarjen e Konstandinit e Gerantinës. Por, e di se i bëra pyetje vetes pse ajo nuk kishte grim në fytyrë, e fytyra e saj

dukej e vyshkur? "Kemi dasmë në familje, ndaj edhe erdha të të tregoj. Kur të vish vishu bukur, që të dukesh më e mira... E di se ç'fëmijëri të lumtur kemi pasur... Kemi vrapuar pas fluturave...", i thashë, teksa shikoja fytyrën e saj të vyshkur. Megjithatë, ajo e dinte se dasmat kishin përfunduar për të, buzëqeshjet i ishin harxhuar nga buzët... Dhe, i zhgënjyer me atë që pash te motra, u nisa për në Prishtinë. Në një udhëkryq më ndalën policia serbe. E ndala pak si më larg tyre... Pa një e pa dy njëri prej tyre shau serbisht pse nuk ua ndala para këmbëve... Ai nuk e dinte mërzinë time... "Vonë u pash dhe nuk duhet të zini pozitë në kthesë, ku nuk ka pamje të mjaftueshme... fola sa për të thënë diçka. "Ti na mëson ku të rrimë ne, a?!", më tha njëri prej tyre me plot ironi dhe e ngriti pendrekun... "Ti e mëson policinë e Serbisë ku me ndenjor, a?!", ndërhyri tjetri, i cili veç bëhej gati t'më mëshonte.

NGJARJA E TRETË

Ngjarjes së tretë po i bie pak më shkurt. Pranë një shitoreje, në Sllovi të Lipjanit, në vitin 1996, disa serbë e rihnin një shqiptar para shitores së tij pse ai u kishte folur shqip e jo serbisht... Sot, me siguri, ata serbë nuk janë aty...

Sokol Murturi



"Heroi"

që e mban familjen nga mbledhja e mbeturinave

Qe 44 vjet, Nexhmedin Berisha, nga Prizreni, "vend pune" e ka grumbullimin e mbeturinave, e që nga shitja e tyre e mban familjen...

Nëse për shumëkënd në Kosovë, e veçmas në Prizren ku jeton ka qenë i pavërejtur, ai është bërë personazh për mediet e huaja. Sepse, mediumi i njohur britanik "Sky News", në një reportazh kushtuar atij, e quan "hero". Nexhmedin Berisha është 66 vjeç, e qe 44 vjet punon si grumbullues i mbeturinave

në qytetin Prizrenit dhe në rrethinë. Por, shkaku i rrugëve të pjerrëta dhe me kalldrëm, e që me ndonjë automjet nuk mund të ngjitet, ai ngjitet e zbret rrugëve me kalldrëm të Prizrenit me kalë, duke mos e ngritur dorën për lëmoshë, por duke e fituar bukën e gojës me djersë.

A jetohet me homoseksualin?

Bazuar në anketat që i zhvilluam kohë më parë me disa gra, në pyetjen: “Sa meshkuj i ke pasur para martesë?”, kryesisht morëm përgjigjen “dy”.



Është interesante se pranuan të flasin vetëm ato që i hasnim vetëm, ose në prani të një shoqeje të saj. Megjithatë, ne po i publikojmë mendimet e atyre të cilat pranuan të flasin...

**FEVZIJA, 52 VJEÇE,
KONTABILISTE:**

**I PARI MË LA, ME TË
DYTIN KALOJ MIRË**

- Për të parën herë jam dashuruar kur isha 19 vjeçe. Por, pas një kohe jam tradhtuar nga ai. Ishte pejan. Me të u njoha në fakultet, që në ditët e para të fillimit në studime. Ia fala virgjërinë dhe krejt tjetër çka deshi dhe iku prej meje e theu qafen diku në Gjermani. Dhe, prej se jam me të dytin as që më kujtohet i pari, madje...

**QAMILJA, 60 VJEÇE,
JURISTE:**

**I PARI MASHKULL
MË DOLI
HOMOSEKSUAL!**

- Nuk e kam lehtë të tregoj publikisht se sa meshkuj i kam pasur në jetë, meqë unë i kam bukur do vjet dhe turpërohem kur flitet për numrin e meshkujve, nëse për asgjë tjetër, për hir të fëmijëve të mi... Me të parin u njoha kur isha maturante, në shkollë të mesme. Ai aso kohe ishte mësuës, punonte. Dilnim bashkë, shëtisnim,

shkonim në Gërmi, por asnjëherë nuk më prekte me dorë! Habitesha edhe vetë se ç'ndodhte me të, derisa një ditë u detyrova t'i thosha se, ndoshta, ishte homoseksual! Ai vetëm u skuq në fytyrë dhe që nga ajo ditë takimet tona filluan të rralloheshin... Qe 35 vjet jam martuar me të dytin dhe nuk them se është lule, por më i mirë se i pari po...

**LULIA, 63 VJEÇE,
ARSIMTARE:**

**ME TË PARIN
QESH E VIRGJËR!**

- Janë bërë rrafsh 40 vjet që jam martuar, kuptohet, me të dashurin e dytë. Të parin me kohë e largova, sepse shihej qëllimi i tij qartë: të ma merrte virgjërinë dhe hajt - nuk qenkemi për njëritjetrin! Andaj, me kohë ia dhashë “pasaportën” dhe u largova prej tij.

PËR FUND

Pse femrat, në biseda të ndryshme, kurrë nuk tregojnë sa të dashur i kanë pasur, por thonë: Burrë e kam të parin. Ndonjëra rrallë thotë të dytin. Ndërkaq, një fëmijë imja, që i ka kaluar të 60-at, jo unë, por e tërë mëhalla e “Lagjes së Muhaxherëve” në Prishtinë, e dinë se i ka pasur disa të dashur. Megjithatë, ka ra në burrë të mirë dhe i ka disa fëmijë...

D. Haxhaj

Modele: Ava Max

BOOM

Pse njohjet
e të njohurve tanë
përfundojnë
me ndarje?

Cilat janë femrat tona
të njohura që i kanë
burrat më të rinj se vetë?

Ava Max

yll i ëmbël, por Pshyco

A close-up portrait of Ava Max with long, straight blonde hair. She is wearing a gold necklace with a Medusa head pendant. The background is a vibrant red, and the lighting is dramatic, with blue and purple highlights on her face and hair.

Ava Max

yll i ëmbël, por Pshyco



Amanda Ava Koci është vajzë me prejardhje nga Saranda, e cila me nofkën Ava Max ka arritur të depërtojë në tregun ndërkombëtar të muzikës dhe të ketë sukses të jashtëzakonshëm.

“Sweet but Psycho” mban titullin kënga, të cilën ajo e ka publikuar të parën dhe e cila bëri boom në arenën ndërkombëtare, duke arritur majat e klasifikimit në Mbretërinë e Bashkuar dhe jo vetëm. Shqiptarja ka arritur të nënshkruajë kontratë me shtëpinë e madhe diskografike, “Atlantic Records”, e cila ka nën menaxhim disa projekte muzikore të Rita Orës dhe Bebe Rexhës.

Kur jemi te shqiptaret e suksesshme, ajo ka arritur të rrëmbejë vëmendjen e këtyre dy të fundit, pasi si Rita ashtu edhe Bebe Rexha, e ndjekin artisten Ava Max në rrjetin social “Instagram”. Kënga “Sweet but psycho” arriti të renditej në vendin e parë në vitin 2018, në top-listën zyrtare të Mbretërisë së Bashkuar.

Dhe, jo vetëm, kjo këngë ka qenë e pranishme thuajse në të gjitha top-listat evropiane, teksa është edhe prej projekteve muzikore më të transmetuara muajve të fundit, në kanalën më të madh të muzikës MTV.

PO, KUSH ËSHTË AVA MAX?

Amanda Ava Koci është e lindur më 16 shkurt 1993, në Wisconsin, nga prindër shqiptarë, të cilët kishin emigrantë nga Saranda në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Ajo publikoi këngën e saj të parë debutuese “Way My Way”, përmes “Records Atlantic”, më 20 prill 2018, teksa më pas ka sjell edhe këngën “Slippin”, në duet me reperin e njohur shqiptar në Amerikë, Gashi.

Ava Max e nisi karrierën e saj në SHBA, ndërsa e vazhdon në Londër – vendin ku familja e saj është shpërngulur prej kohësh.

Ajo është, gjithashtu, pjesë e një prej këngëve të albumit “7” të DJ-të me famë botërore, David Gueta, i cili në valën e shumë këngëve të suksesshme brenda albumit, pat edhe këngën “Say my name”, në bashkëpunim me artisten tjetër shqiptare me famë botërore, Bebe Rexha.

Spektaklet e dashurisë, apo njohjet e të njohurve tanë, kanë qenë gjithmonë në qendër të vëmendjes në vendin tonë. Mirëpo, çiftet që krijohen në këto formate duket se nuk zgjasin. Ndonëse pretendohet që ata gjejnë dashurinë e jetës, pas një kohe ndahen! Ja disa prej tyre...



MIMOZA SHKODRA DHE SELDI QALLIU

Një kohë të gjatë ishin ndër çiftet më të komentuar të shou-bizit shqiptar. Seldi Qalliu dhe Mimoza Shkodra dukeshin tejet të lumtur krahas njëri-tjetrit dhe dashurinë e tyre e kurorëzuan edhe me fejesë. Por, u ndan krejt papritur!

Pse njohjet e të njohurve tanë përfundojnë me ndarje?



BEATRIX RAMOSAJ DHE DONALD VESHAIJ

Kohëve të fundit është komentuar shumë ndarja e Donald Veshajt dhe Beatrix Ramosajt. Lidhja e tyre nisi shumë shpejt brenda "Big Brother VIP" dhe zgjati vetëm një ditë pas mbarimit të formatit. Nuk dihet pse ata u ndanë, por ata më nuk janë më bashkë.




KIARA TITO DHE BUTRINT IMERI

Ndonëse nuk e pranuan kurrë, këngëtari Butrint Imeri u përfol gjatë në mediet online për lidhjen me moderatoren simpatike Kiara Tito. Çifti, madje, u kapën mat teksa shijonin pushimet në të njëjtin vend apo pinin kafe në lokal të Prishtinës. E gjitha nisi nga një intervistë e Butrintit me Kiarën më 2018, kur ajo e puthi në studio e më pas duket se ata vijuan njohjen. Megjithatë, nuk dihet arsyeja pse u ndanë, ndonëse thuhet se shkaktare ishte nëna e Butrintit.



DAFINA DHE LEDRI

Gjatë kohës që ishin bashkë, Dafina Zeqiri dhe Ledri Vula konsideroheshin si "power couple". Ata ishin bashkë brenda dhe jashtë skenës, duke formuar një nga çiftet më të dashur të publikut. Lidhja e tyre mori fund më 2016, e arsyeja nuk dihet.



NORA ISTREFI DHE ROBERT BERISHA

Nora dhe Roberti janë shembull perfekt se pas ndarjes, ish-partneri mund të jetë shoku më i mirë.

Pas dasmës së bujshme dhe 13 vjet në krahët e njëri-tjetrit, çifti vendosi që ndarja ishte zgjedhja më e mirë për ta.



SHPATI KASAPI DHE AFËRDITA DRESHAJ

Shpati dhe Afërdita ishin me vjet në qendër të vëmendjes. Ata i dhanë fund lidhjes së tyre në vitin 2013, pas një fejese gjashtëvjeçare. Këngëtarja dhe modelja është e martuar me sportistin e hokejt, Jakub Kindlm, me të cilin ka një djalë.

E, Shpati është martuar me një make-up artiste dhe pak muaj më parë mirëpritën në jetë fëmijën e tyre të parë.

Cilat janë femrat tona të njohura që i kanë burrat më të rinj se vetë?

Në kulturën shqiptare mosha zë vend të veçantë në një marrëdhënie, ku partneri “duhet” të jetë më i vjetër se partnerja. Andaj, cilat janë femrat tona të njohura që i kanë burrat më të vjetër se vetë?



TEUTA KRASNIQI DHE ADONIS MORINA

Aktorja Teuta Krasniqi është e martuar me trajnerin e fitnesit Adonis Morina. Adonisi është më i ri se Teuta.

VENERA LUMANI DHE LIND ISLAMI

Venera dhe Lindi janë çift i njohur i shou-bizit shqiptar. Venera është 1 vit më e vjetër se Lindi.





**AMARDA TOSKA
DHE ERMAL MAMAQI**

Amarda Toska (Ami) është një vit më e vjetër se burri i saj, Ermal Mamaqi.

**ARBANA OSMANI
DHE EDUART GRISHAJ**

Moderatorja e njohur, Arbana Osmani, është 4 vjet më e vjetër se partneri i saj, Eduart Grishaj, regjisor.



AURELA GAÇE DHE SKERDI

Edhe Aurela Gaçe ka krahu saj një partner më të ri në moshë. Ajo dhe bashkëshorti, Skerdi, kanë dy vite diferencë.



Pse më vardisen veç të moshuarit?

Historia e saj është vetëm histori e njëjës nga ato. Nuk është prostitutë, sepse nuk pranon para prej askujt. E rëndësishme për të është se ajo shijon kënaqësinë e çastit, shëtit me vetura të mira, shëtit nga njëri vend në tjetrin, provon dashurinë me aromën e njerëzve të parfumosur, madje edhe me politikanë...

Shtati i saj i hedhur, gjoksi i saj i madh, u bie në sy meshkujve të moshave të ndryshme, madje edhe atyre dukshëm më të vjetër se ajo. Së pari, filloi lidhjen me një djalosh simpatik, por nuk shkoi shumë dhe lidhja e tyre u ndërpre, shkaku se ai nuk kishte mundësi ta shëtiste ku dëshironte ajo...

FAJET I KA "X5"!

Ndërkohë, njihet me një biznesmen, i cili kishte veturë të mirë, "X5". Dhe, pas një kohe merr vesh se biznesmeni ishte i martuar, se i kishte 3 fëmijë!

Andaj, edhe lidhjen e saj e shihte si të përkohshme, kështu që iu dha kënaqësisë dhe asgjë më shumë... Dy vjet më parë ajo u njoh edhe me një politikan, i cili që në taki-

min e parë ia bën me dije se është i martuar, madje ka edhe fëmijë. Ajo nuk dëshiron ta bëjë publik emrin e tij, sepse ai nuk e ka mashtruar, me kohë ia ka bërë me dije se lidhjen mund ta krijojnë vetëm për kënaqësi dhe asgjë më shumë...

PSE I VARDISEN POLITIKANËT?

Por, kohëve të fundit ka filluar t'i vardiset edhe një politikan tjetër, por jo i rangut të atij të mëparshëm. Dhe, shpesh, siç thotë ajo, i bën pyetje vetes: Pse më vardisen politikanët? Mirëpo, mbetet pa përgjigje... E, deri kur kështu, e di vetëm ajo... Keq, a?

D. H.



Bëhu pjesë e Kompleksit Ulpiana Center

+383 49 50 90 90



www.cimaks.com



We bring the future to the present...

Pse nuk e kam gruan shqiptare?

Gjatë studimeve u njoha me një nxënëse të bukur të shkollës së mesme në Ferizaj. Më pëlqeu që në shikim të parë. Por, vetëm pasi u martuam e kuptova se nuk ishte shqiptare.

Pas kryerjes së shkollës së mesme u regjistrova në Shkollën e Lartë në Ferizaj. Gjatë studimeve rastësisht u njoha me një maturante të shkollës së mesme teknike, e cila jo vetëm që ishte e bukur, por edhe tërheqëse dhe e shoqërueshme. Por, tek pasi e kreu shkollën e mesme miqësia jonë kaloi në diç më shumë se shoqëri... Shkurt e shqip, rashë në dashuri me të.

IU HODHA NË PËRQAFIM SI I TRENTË!

Një ditë, kur edhe dhashë njërin nga provimet me rëndësi, posa dola nga oborri i fakultetit, si prej qielli piku ajo. I gëzuar nga provimi që e dhashë iu hodha në përqaftim. Ajo u tremb, u hutua dhe nuk dinte ç'të bënte... Shpejt e putha në buzë, pastaj në faqet si molla. Dhe, pasi u ulëm në ëmbëltoreshë që

ishte afër, ia shpreha të gjitha... Më pas, kur u ngritëm, erdhi me mua për herë të parë në veturën time. Ia mësova Jezercit. Dhe, kur arritëm në një kthesë ku nuk shihej rruga, veturën e futa në brendi të disa shkurreve. Filluam të putheshim, të ledhatoheshim, të shtrëngoheshim, të zhvisheshim, edhe pse për mua kjo ishte hera e parë...

KËRKOI TË MARTOHESHIM PA DASMË!

Ditët kalonin e çdo ditë e më shumë më hynte në zemër. E ajo, duke e vërejtur këtë, më bënte presion që të mos fejohehim, por të martoheshim sa më shpejt dhe pa dasmë, madje pa dijeninë e familjes së saj, sepse, thoshte, nuk do e lejonin të martohej... Dhe, një ditë vjeshte, nga rruga e solla në shtëpi. Familja ime e pritën mirë. Të

nesërmen filloi jetën si nuse, me punët e shtëpisë...

Pas një muaji, me insistimin tim, u nisëm për në shtëpinë e saj, sepse doja t'ia njihja familjen, ani pse edhe më tutje dëshironte të mos kontaktoja me familjen e saj.

Kur arritëm në lagjen e saj, në Kaçanik, u stepa kur pash disa shtëpi të vogla në pjesën jugore të Kaçanikut.

Disa fëmijë të lagjes, kur na panë nga larg, filluan të vraponin drejt nesh. Kur na arritën, iu hodhën në qafë gruas sime... Nga fëmijët, por edhe familja e saj pash se ata ishin magjupë.

Dhe, më kot u mundua t'më bindë se janë shqiptarë, se gjithmonë kanë pasur ngjyrë paksa të zezë...

Por, edhe pse pas një viti u ndamë, as sot e kësaj dite nuk ka njeri t'më bindë se ajo ishte shqiptare.

R. D.



Keq po, por...

Shyqyr Zotit, gruaja ende nuk po ma nduk mjekrën!

Nastradini për djalë donte një nuse paksa të verbër, që ajo t'i shihte gjërat pak, si kusht që ta ruante shtëpinë. Donte nuse të shurdhër, që të mos i dëgjonte, të paktën, gjysmën e fjalëve në shtëpi, si dhe donte nuse të çalë në njërën këmbë, e që, po qe se do nervozohej, të mos mund ta zinte Nastradinin.

Marrë një libër nga sociologjia ta lexoj. Nuk gjej asgjë pos gjëra të përgjithësuara, rregulla. Pastaj, marrë librin që flet për kanunin, që të gjej se ç'thuhet për sociologjinë e nuseve.

Por, një gjë e tillë nuk më pëlqen, sepse nuk mund të zbatohet Kanuni i Lekë Dukagjinit në ditët e sotme. Për t'u zbatuar kanuni, duhet të rrenohen me themel objektet e fitnesit, marketet të shndërrohen në ish- "zadruga", në të cilat nuk shkonin gratë, duhet të mbyllet të gjitha fabrikat që prodhojnë xhinse të shqyera e të pa shqyera, duhet t'u ndalohet grave t'i ngasin veturat, e shumëçka tjetër...

Dhe, në vitrinë shoh kryeveprën e kohëve, librin me anekdota të Nastradin Hoxhës. E shfletoj dhe lexoj se si Nastradini, para se t'i gjente nuse djalit, kishte dalë në shtatë fshatra dhe kishte kërkuar nuse për të birin. Kushtet për të qenë nuse e djalit të tij ishin: Të jetë e verbër në njërin sy; të jetë gungaçe; të jetë e çalë në njërën këmbë; të ketë gjuhë të vogël; të mos ketë flokë të gjata.



NASTRADINI NË SHTATË NAHI MEZI E GJETI NJË NUSE PËR DJALË!

Kur shkoi në fshatin e fundit të nahisë, gjeti një vajzë përafërsisht siç e kërkonte dhe e mori me vete. Kur e solli në shtëpi, erdhën mëhalla t'ia urojnë renë.

E, kur e panë nusen të verbër, e pyesin: "A nuk pate sy Nastradin që e more këtë re të verbër, a? A e di çfarë djali të bukur ke? Qysh e ke marrë këtë re me një sy?"

"E gjeta një re të tillë për djalë, sepse ajo i sheh vetëm gjysmën e gjërave që ndodhin në shtëpi, kurse rejat tuaja shohin dyfish! E kam marr më një këmbë të çalë, sepse, nëse nervozohet, nuk mund të na zë të na rrahë! Është pa flokë të gjata dhe nuk ka nevojë të shkojë çdo ditë te floktarja për t'i dredhë e zhredhë!", thotë Nastradini.

"Ani, mirë, po pse e more gungaçe?", pyetën.

"E, ku të gjesh re pa behane?!", ia kthen Nastradini.

"Po, çka nëse reja sheh dyfishë më shumë me njërin sy se sa me të dy?", e pyetën.

"Erdhi një herë një mysafir dhe gruaja ime, meqë nuk i do mysafirët, mbyllet në dhomë. Erdhi koha e bukës dhe gruaja askund nuk dukej që ishte kah guantuante. U ofrova në dhomë dhe i thashë: "Grua, na bëj diçka me ngrënë se miku im është nga larg dhe duket i uritur", përgjig-

jet Nastradini.

Gruaja e kapë mashën dhe e qëllon Nastradinin në vetull dhe ia shqyen vetullën. Nastradini kthehet i përgjakur në odë.

Posa e pa, mysafiri u ngritë në këmbë që t'ia pastronte gjakun dhe i thotë: "Hoxhë efendi, për mua mos bëj gjë se nuk dua që t'u gjejë çfarëdo e keqe me grua!".

"Po, ajo e ka kështu, ndonjëherë, o mik, kur e kapin ato të vetat gjuan me çka do që ka në dorë!", ia kthen ai.

S'E LEJOJ GRUAN T'MË KAP PËR MJEKRE!

Mysafiri, duke dashur ta zbusë situatën, i thotë: "Mos u merakosë se gruaja ime, kur ka probleme dhe është nervoz, më kap edhe për mjekre! A e sheh mjekrën sa të rrallë e kam?! Më janë rralluar qimet duke m'i ndukur gruaja!".

Kur e dëgjoi Nastradini rrëfimin e mysafirit, i tha: "O mik, ti mos e krahaso veten me mua, sepse unë s'kam lejuar kurrë t'më kap gruaja për mjekre, prandaj unë dhe ti jemi ndryshe njëri me tjetrin, sepse unë jam burrë dhe nuk lejoj që gruaja të luajë me mjekrën time! Andaj, gjithçka mund të lejoj, por t'më kap për mjekre këtë nuk mund ta duroj!".

HELPER
GENEVE



www.helperwatches.com

 /helper_lifestyle

Fëmijët tuaj *nuk janë bijtë tuaj!*

Gibran Khalil Gibran

Fëmijët tuaj nuk janë bijtë tuaj,
Janë bij e bija të etjes që jeta ka për vetveten,
ata vijnë nëpërmjet jush, por jo nga ju,
edhe pse jetojnë me ju, nuk u përkasin.
Mund t'u dhuroni atyre dashuri,
por jo mendimet tuaja:
ata kanë mendimet e veta.
Mund t'u jepni strehim trupave të tyre,
por jo shpirtave të tyre:
ata banojnë në shtëpinë e së nesërmes,
të cilën nuk do u lejohet ta vizitoni as në ëndërr.
Mund të provoni të jeni si ata,
por jo t'i bëni të ngjashëm me ju:
Jeta ecën e nuk vonohet me të shkuarën.
Ju jeni harqet, prej ku bijtë, si shigjeta të gjalla,
janë hedhur përpara.
Harkëtari sheh pikësnyimin në horizontin e pafund
dhe ju tendos me forcë, derisa shigjetat e tij
të shkojnë shpejt e larg.
Besohuni me gëzim në dorën e harkëtarit,
pasi siç do fluturimin e shigjetës,
ashtu do edhe shtrëngimin e harkut.

Letra e fundit **e dashurisë**

Nuk po të shkruaj për të të thënë se dikur të kam dashur shumë, as për të të thënë se për ty kam derdhur shumë lot... Ajo që sot më shtyn të të shkruaj është të të them se më nuk kam mall për ty!
Sidoqoftë, respekti për ty është e vetmja që më ka mbetur brenda meje dhe nuk dua ta zhduk, por do të jetoj me kujtimin për ty, me ëndrrat që i kishim bashkë, ato miliona ëndrra. Tash më shumë të konsideroj si një mikeshë të vjetër dhe hiç më shumë...

Ish – hamshori yt

Radio,
Lajme, Moti,
Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin
Shkabaj për Android

ANDROID APP ON
Google play

Shkabaj
Foto Akesi
www.shkabaj.net



DENTFIX

ORDINANCA STOMATOLOGIJE

Jam e bukur, por...

Burrin nuk mundem me e pa me sy!

Jam femër shumë e bukur të gjithë më kanë lakmi, por burrin nuk mund ta shoh me sy!

Jam martuar e re, posa e kreu shkollën e mesme, kurse tash jam 45 vjeçe. Fëmijët i kam të rritur. Burrin e kam të lazduar, jo ndaj femrave të tjera, për i lazduar në familje, sepse mburret kë e ka grua...

Të gjithë çuditën si është e mundur ta duroj aq shumë, por për hir të karakterit tim e të familjes, por edhe dashurisë, e duroj, duke e përkrahur në çdo gjë, duke e pritur me vite e vite që t'më merrte me vete në Gjermani, ku ka vjet që jeton.

IA GJETA SMS-të SE MË TRADHTONTE!

Menjëherë pas lufte arriti të më merrte në Gjermani, ku edhe u rehatua me ndihmën time. Njerëzit që na njihnin nuk besonin se ai ka ndryshuar, duke më lavduar mua se e drejtova në rrugë të drjetë, për të mirën e tij e neve.

Por, ajo rehati nuk zgjati edhe aq shumë,

meqë e kuptova se me ka tradhtuar gjithë kohën me një vajzë shumë më të re se unë...

Një ditën në telefonin e tij hasa në tre sms. Kur i thashë se i kam lexuar sms-të, nuk pranoi assesi, madje edhe më ofendoj pse po e konsideroja tradhtar.

EDHE UNË NJËFARQ DREQI PO...

Por, edhe unë njëfarë dreqi po. Bëra çmos dhe rash në numrin e telefonit nga kishin ardhur sms-të. Kur i tregova kush jam, në vend që të më qortonte, më tha – boll mirë ke ba që më ke thirrë.

Dhe, fjalë pas fjale, nisi t'i tregoj gjërat më të këqija për tim burrë, se si e kishte mashtruar se kinse kurrë nuk ka qenë i martuar, sepse nuk hasur në femrën që do e dashuronte...

Më kërkoi falje mua, më tha se u kërkoi falje edhe fëmijëve të mi...

Dhe, nga ajo ditë më kurrë s'e kam dashur, madje e kam urreyer me mish e shpirt! Shpesh kam edhe depresion dhe habitem se si, një femër të bukur si mua, më ka tradhtuar, ndoshta me ndonjë lavire, sepse kurrë s'kam arritur ta shoh, meqë nuk ka pranuar të takohemi...

I KEQI NUK NDËRRON, VETËM GËZOFIN E RROTULLON!

Kurrë nuk më ka shkuar mendja se me mua mund të ndodh diç e tillë, sa herq që ndoëgjoja për raste të tilla. Sepse, thosha me vete, bukuria ime nuk e lejon të më tradhtoj me ndonjë tjetër...

Dhe, për hirë të fëmijëve sakrificova. Ula kokën dhe heshta. Ndërkohë, një gjë e kuptova: I keqi nuk ndërron, vetëm gëzofin e rrotullon!

R. Rrahimi

Pse rejat e mia nuk e duan gruan time?!

“Mirëdita!”, u them reja. E, ato, paksa me përtesë, si nëpër dhembë, përgjigjen: “Mirëdita!”.

Secila telefonin në dorë...

Gruaja më shikon në sy dhe ma pret:

“A do kafe a çaj?”

“Dua çaj”, i them.

Ngrihet gruaja dhe nis drejt shporetit. E

vë gjygymin mbi shporet dhe herë-herë

më shikon mua. Rejat nuk flasin. Çile gur

gojën, siç thotë populli.

Ah, keq qenka bërë në shtëpinë time! - e

mendoj në vete.

“Rejat e mia, a u ka rrahur kush?!”, i pyes

unë.

“Vallahi mua s’ka kush t’ më rrah se burri

im është tri ditë larg me aeroplan!”, thotë

më e reja.

“Te ne është super, se ende askush nuk na

ka thënë të dalim nga shtëpia!”, ndërhy

gruaja si me sherr.

PSE GRUAS SIME

NUK I FLASIN REJAT?!

Dhe, pas pak, hyj në “botën” e shtëpisë sime dhe shoh se një atmosferë e zymtë shihet në fytyrën e gruas sime, e cila qenkësh bërë e huaja në shtëpinë e saj, ku ka

jetuar, jeton dhe punon me dekada...

“E ti, grua?”, i them sa për të vazhduar bisedën.

“Unë, kështu, çdo ditë, njeri... Rri vetëm...

Nuk më flet askush! Kur dalin, fëmijët m’i

lënë mua! Kur kthehen as që më falënderojnë! Madje, më thonë: “Fëmijët e

djemve tu janë!”.

“Kështu të thonë, a?!”, i them, teksa më

rrëqethet trupi.

“Burrë, mos më bë nervoz, se nuk je në

ngjarje fare! Përcille pak situatën dhe

bindesh vetë!”, ma ktheu ajo.

“Çudi, si nuk e paskam vërejtur një gjë

të tillë, bre! Qenka prishur harmonia në

shtëpi! Nuk na paska mbetur gjë tjetër,

veç të dalim edhe ne e të ecim si fqinji

ynë...

Por, ne do të shkojmë pak më larg se ai...

Dhe, kur të kthehem, mund ta gjejmë

shtëpinë mbyllur, duhet t’i presim rejat

derisa të kthehen që të na e hapin derën...

Është përzier puna në shtëpinë tonë... E,

kur përzihet shtëpia humbin të drejtat për

ankesa.

“Ne nuk e kemi bërë vendin për t’u an-

kuar!”, i them gruas.

SI IA GJETA ILAÇIN GRUAS SIME?

Dikur, kur kërkohej nuse për djalë, pyesnin

nga e ka nënën, nga i ka dajallarët... E, tash

nuk pyet kush as nga është nusja, se lëre më

për nënën a dajallarët e saj... Sot u intereson

a është nusja e bukur a jo. Dhe, pikë.

“E gjeta ilaçin grua!”, i them.

“Fol, çka?!”,

“Kur i gjetëm djalit të madh nuse, më the

nuk më intereson kah është veç a është

e bukur! Edhe për djalin e dytë ishte po

me ato fjalë... Kurrë nuk të kam dëgjuar të

thuash, o njeri, të pyesim kah e ka nënën,

çfarë loze ka, a mos është pirravinë që na e

mbushë arën me bari...

E, tash, mos e zgjatë më shumë se vetë i ke

fajet!”, ia kthej unë.

“Po-po, kjo është e vërtetë, prandaj le ta

kapërdijmë “bukën” deri të na mbetët në

fyti!”, ma ktheu ajo.

Pjella e keqe ta prishë shtëpinë!

*Sot nuk pyet askush
kah e ka nusja nënën,
as babën, por vetëm a
është e bukur a jo...*

E nisa mbrapsht këtë shkrim, sepse unë nuk po mund t'i përcjellë proceset e tranzicionit, pjesë e të cilit është bërë çdo familje...

Shoh fqinjin tim si del çdo mëngjes nga shtëpia dhe nisjet në drejtim të zabelit, më pas kah kodra e Surgjakut, ku gurëthyesit ia kanë prishur bukurinë kodrës sime të bukur, duke shkatërruar ekologjinë.

I them gruas:

"Ku shkon fqinji çdo mëngjes?"

A thua, është keq me mushkëri e del në ajër të pastër?

A thua, i nevojitet ecja?"

Por, as këtu më ajër të pastër s'ka. E, as ecja nuk i duhet, sepse është tharë si lisi që e ka tharë koha...

"Lëre njeri, a nuk e di, a?!", më tha gruaja.

"Çka të di, unë tërë ditën në punë!", ia ktheva.

"Nuk ka ku të rrijë në shtëpi! E kanë marrë nëpër këmbë. Askush nuk e do, askush nuk e çmon! I ka humbur udha në oborr, siç thuhet. Del nga shtëpia dhe ia therr kah mundet!"

SA KISHA DASHUR TË JE FRANCEZ!

"I zoti i shtëpisë ka mbetur pa respekt, a?!", ia kthej me habi.

"Po, çfarë i zoti ai, bre?! Mos u bë francez!", më thotë me neveri.

"Unë francez, a?! Mirë do të ishte të jem edhe francez, vetëm të mos jem kështu si jam, sepse fatin e keq e kisha pas moj grua. Po shoh keq e po më dhemb shpirti, e nuk po kam fuqi gjërat t'i ndryshojë. Po lëndohem nga pamjet e shëmtuara që po ndodhin çdo ditë..."

Madje, nuk e paskam ditur se e paskësh gjetur zezëdita fqinjin tonë, që ishte një zotëri i anës sonë. Është ditur kur zgjohen në shtëpinë e tij anëtarët e shtëpisë; Është ditur kur fiken dritat natën; Është ditur kur lidhet qeni i shtëpisë; Është ditur kur tymon oxhaku e kur qitet

pushkë...

E tash, nuk po u ditka a këndon pula a gjeli në shtëpinë e tyre. Pse kështu, moj grua?!", e pyes me habi.

"Kur e përzien pjellën e keqe, ajo shtohet pa kontroll e ta prishë shtëpinë, njeri! Ash-tu si e prishë pirravina arën! Pirravina kudo që prekë në tokë qet rrënjë dhe e mbushë arën bari dhe nuk ka më aty bereqet! Edhe familja e fqinjit tonë është e tillë, është mbushur shtëpia me lozë të këqija e burri i shtëpisë nuk ka vend më aty", ma kthen me plot bindje.

EDHE NË SHTËPINË TIME KANË NDRYSHUAR GJËRAT!

"Haj medet çka e paska gjetur fqinjin tonë!", i them gruas, më shumë për ta përmbyllur këtë muhabet.

Por, gruaja nuk ndalet me kaq...

Më thotë të mos e marrim nëpër gojë askënd, sepse edhe në shtëpinë tonë kanë ndryshuar gjërat...

T. M.



PARA

PAS



20 SEANCA

-13 KG

Qendrat e dobësimit 'Shkenda Dubova' janë ndër bizneset më të suksesshme të vitit. Duke filluar me një degë të vetme në Prishtinë, biznesi i Shkendës sharmante, ka kaluar kufijtë kosovar. Tani, qendrat e dobësimit gjenden edhe në Shqipëri, Gjermani dhe Zvicër, e njëkohësisht pritret që të hapen edhe nëpër vende të tjera të botës.

Gjithsesi, suksesi i tillë vjen si rezultat i punës së palodhshme të Shkendës dhe stafit të saj, mirëpo edhe i shumë storjeve të suksesit, të qindra klientëve të kënaqur.

Kush thotë që një femër nuk është e denjë për biznes?!

Shkenda Dubova e dëshmon të kundërtën, duke qenë shembulli më i mirë i femrës kosovare të suksesshme.

Shumë mund të pyesin se si ndodhë i gjithë procesi i dobësimit tek këto qendra, me rezultate kaq të dukshme tek klientët? Çdo klient fillon me seancat e shkrirjes së dhjavit, përmes aparaturave më moderne, që janë në përputhje edhe me standardet evropiane të teknologjisë së dobësimit.

Kështu, klienti së pari i nënshtrohet një analize trupore, ku përcaktohen: masa dhjamore, masa hidrike, masa muskulore dhe skeletore, si dhe metabolizmi. Si rezultat i kësaj terapie, klienti humbet 5-8 kg në 10 seanca të plota dobësimi, me një reduktim të perimetrit deri në 10 cm, për vetëm 10 seanca.

I gjithë ky proces ndodhë falë këtyre aparaturave, karakteristikat e të cilave do t'i shohim në vijim:

- Perfect Body-Tunnel Sauna - Është një aparaturë e teknologjisë së fundit, dhe rezultat i një projekti të gjatë kërkimor, efikasiteti i së cilës është verifikuar shkencërisht në të gjitha aspektet mjekësore e teknike, pa efekte anësore, e po ashtu, edhe kuruese për shumë sëmundje. Kjo aparaturë funksionon duke aktivizuar molekulat e ujit, që përmirësojnë thithjen e oksigjenit, qarkullimin e gjakut dhe nxisin metabolizmin. Rrezet infra të kuqe të afërta dhe të largëta, kombinohen për të depërtuar në indet e lëkurës deri në 30% (6 mm nën epiderme), duke shpërbërë grumbullimin e yndyrës të lokalizuar në bark, vithe dhe kofshe. Në mjekësi, IR përdoren për shërimin e shumë sëmundjeve si: sëmundjet reumatike, sëmundjet degjenerative të nyjeve, gjendjet postraumatike (kryesisht sportistët), inflamacionet e hapësirave paranazale etj.
- Body Shape-Kabina e Shtrirë - Një tjetër pajisje që sjellë benefite të jashtëzakonshme për shëndetin, e në veçanti në humbje të peshës. Kjo aparaturë realizon një funksion të rëndësishëm në relaksim dhe detoksifikimin e tyre, duke larguar toksinat dhe acidin laktik. Benefitet kryesore të kësaj aparature janë:

- Riaktivizon metabolizmin dhe ndihmon në eliminimin e shtresave të tepërta dhjamore, duke eliminuar kilogramët, dhe duke ofruar rimodelimin e formës trupore;
- Lehtëson dhimbjet nga patologji të ndryshme, si dhembjen e kurrizit, nervit ishiatik, artritin, reumatizmin;
- Rritë qarkullimin e gjakut duke furnizuar kështu indet dhe çdo pjesë të trupit, me elemente ushqyese;
- Tonifikim i thellë;
- Përmirëson shëndetin e zemrës dhe ulë stresin;
- Përmirëson sistemin nervor;
- Zhdukë në mënyrë të ndjeshme celulitin duke eliminuar shtresat dhjamore;
- Ngadalëson efektin e plakjes, duke përmirësuar dukshëm elasticitetin dhe butësinë e lëkurës;
- Përmirësim i dukshëm i drenimit të toksinave dhe i lëngjeve;
- Detoksifikim i organizmit, rritje e forcës dhe fleksibilitetit;
- Lehtëson gjendjen e depresionit;
- Efekt analgjektiv;
- Lehtëson dhimbjen dhe përmirëson lëvizjet te personat që kanë sëmundje reumatike, etj.

• Sauna Tradicionale nga Druri i Pishës - Është aparaturë ku përmes efektit termik të nxehtësisë, ndihmon në eliminim e shtresave dhjamore dhe humbjen e peshës. Disa nga benefitet e saunës me nxehtësi janë:

- Detoksifikim;
- Përmirëson qarkullimin e gjakut dhe ulë tensionin arterial;
- Humbje të peshës;
- Eliminon celulitin edhe nga zonat më delikate;
- Relaksim muskolor, etj.

• Pajisja e Dobësimit Intensiv (Ultra Sonik) - Kjo pajisje funksionon përmes valëve sonike të frekuencës 40000Hz, të gjeneruar nga sonda. Pasi valët hyjnë në trupin e njeriut, gjenerohet efekt intensiv goditës në qelizat dhjamore, si dhe lëvizje ndërmjet qelizave dhjamore, të cilat në mënyrë efektive djegin energji, dhe kështu ndodhë tkurrja e qelizave dhjamore. Ndërkohë, vibrimi i valëve sonike, shkakton ndikim intensiv midis qelizave, të cilat shpërthejnë menjëherë, duke zvogëluar numrin e qelizave yndyrore dhe arrijnë efektin e heqjes së dhjavit.

• Elektrostimulorët Muscular - Ky është procesi i fundit që bëhet gjatë një seance. Është një proces shumë i rëndësishëm, përderisa jeni duke shkrirë dhjavin, përmes elektrostimulimit, tonifikohet trupi, nuk e lë të varet dhe të qullet trupi, si dhe stimulohen muskujt dhe ngushtohet perimetri.

Nëse i keni këto vija në duar, keni fat në dashuri!



Nëse shikoni me vëmendje shuplakat e duarve, do të shihni shumë vija dhe një nga më të rëndësishmet është “Linja e zemrës”, e cila quhet edhe “Linja e dashurisë”. Ajo kalon mbi të gjithë shuplakën dhe mund të jetë më e gjatë ose më e shkurtër.

LINJAT NË TË NJËJTËN LARTËSI

Ky pozicion i linjave të dashurisë tregon se ai është një person inteligjent dhe i organizuar, që i pëlqen gjërat të shkojnë sipas planit. Ai hyn në një lidhje serioze dashurie vetëm kur është i sigurt se personi është i denjë për besim dhe vëmendje. Ata i duan marrëdhëniet e qëndrueshme dhe afatgjata dhe janë

të gatshëm të bëjnë gjithçka për dashurinë e vërtetë.

VIJA NË PËLLËMBËN E DJATHTË ËSHTË MË E LARTË

Ai nuk përshtatet me tendencat moderne dhe pëlqen të jetojë sipas rregullave të tij. Zgjedh partner më të vjetër, sepse vetëm me të arrin të gjejë gjuhë të përbashkët.

VIJA NË SHUPLAKËN E MAJTË ËSHTË MË E LARTË

Të tillët shpesh e kalojnë jetën e tyre në vetmi, duke kërkuar shpirtin binjak. Nuk bëjnë pjesë në grupin e njerëzve që do të qëndrojnë në një lidhje vetëm për të mos qenë vetëm. Marrëdhëniet sipërfaqësore nuk i tërheqin. Janë besnikë dhe të përkushtuar ndaj jush.



-30%

WEEK DAYS

March 2022

VALID FOR 2 OR MORE NIGHTS



Adresa: R210 Sterpce; **Tel:** 0682007891; **Email:** reservation@atdg.al;  /kompleksimeshtekna

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për stresse, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Letra prekëse e një nëne

Përshëndetje, zonzjë! Jam nënë, 45-vjeçare, vuaj nga një sëmundje e rëndë. E kam vetëm një djalë, që na e fali Zoti vonë. Pas lindjes së djalit burri im vdiq aksidentalisht, e më la të përballim me djalin...

Nuk më dhimbset vetja ime se edhe ashtu kam pasur jetë të rëndë, si te familja ashtu edhe në martesë.

Por, nuk di çka do të ndodhë me djalin. Askush nuk i ka kushtet ta rritë e të merret me të...

Jam e sëmurë, por më shumë e plagosur në shpirt për tim bir se si do të jetojë pa mua, si do arrijë ta sigurojë kafshatën e gojës...

"Nëna me lot"

Përgjigje:

Para së gjithash, Allahu xh. h. ka kushte për të gjithë. Ka edhe ilaçe për të gjithë, ashtu sikur mund të ketë edhe për ty.

Ka bukë edhe për djalin tënd, e edhe për fëmijët tanë. E, më e rëndësishmja është të shërohesh ti dhe të jetosh bashkë me të birin, derisa ta shohësh të martuar e me fëmijë.

Mos e paragjyko të keqen, jetoje jetën me dinjitet, por kujto se në botë ka drama shumë të tmerrshme njerëzore, e që ndodhin edhe në vendet më të zhvilluara... Dhe, sot pakkush është i lumtur

nga jeta dhe pak kush di t'i gëzohet jetës...

Këtë pakënaqësi njerëzore të këtij shekulli e dëshmon fakti se në çdo 40 sekonda një njeri bën vetëvrasje në botë, ia merr jetën vetes, duke mos qenë i kënaqur me asgjë dhe duke mos parë dritë në fund të tunelit.

E, sa i përket sigurisë jetësore, askush nuk jemi të mbrojtur as nuk kemi garanci se do jetojmë as deri nesër.

Shpërfaqja e cilësdo sëmundje është vetëm një alarm, që bëhet i ditur për çdo kë se në moment është pacient. Por, pak kush di se për çdo ditë në trupin e njeriut vdesin rreth 36 milionë qeliza, që kanë të bëjnë me ndryshimet metabolike.

Kjo tregon sa të pambrojtur jemi përballë sfidave të shekullit XXI, që ka më shumë tym e gaz sesa shëndet...

Andaj, mos u dëshpëro, por kujtoji të gjitha këto dhe mendo bardh e jo zi. Te njeriu është një motor që e shtyn tërë makinën: Shpresa! Ajo nuk duket, por e bën shpirtin të besojë të mirën dhe kalimin e krizës.

A kam depresion?

Jam vajzë, 32-vjeçare, jetoj në Suedi. E dua një djalë me të cilin shihemi më shumë në vendin e punës. Por, nuk jam e vendosur për askënd, sepse më duket se kam depresion.

Kështu, dashurohem shpejt dhe, pastaj, nuk mund t'i shkoj deri në fund asnjë lidhjeje. Kam probleme me veten time, nuk jam e sigurt në rrugën që marrë.

A kam depresion apo çka po ndodh me mua?

"E hutuara"

Përgjigje:

Ti ke pasur një lidhje disavjeçare me një djalë dhe, pastaj, jeni ndarë. Keni pasur ambicie të martoheni.

Por, shkakut i një kredie e kenit prishur lidhjen tuaj dhe tash s'ke disponim për dikë tjetër.

E, shpirti yt fle tek ai që, siç thotë populli, "e ka hequr duvakun tënd". Andaj, për të qenë me dikë tjetër duhet kaluar kohë. Kështu, nuk shoh se je e gatshme për një lidhje të re, sepse truri dhe shpirti duhet të mësohen me një pamje të re dhe me një sjellje të re, që vjen përmes personit që do ta gjesh.

Por, koha shëron, thotë populli.

Nuk po mbetëm shtatzënë. Pse?

Jam grua, 38-vjeçare, jetoj jashtë Kosovës. Jam martuar pak me vonesë, por nuk po mund të mbetëm shtatzënë.

Kohëve të fundit jam edhe nervoz dhe po më pengon gjithçka...

A do të kem fëmijë?

"Mbrëmja"

Përgjigje:

Stresi krijon frikë. Por, ti ke edhe nervozë edhe frikë. Dhe, këto të dyja pengojnë mundësinë e shtatzënisë. Sidoqoftë, nuk do të thotë se nuk ka mundësi të mbetesh shtatzënë pse je nervoz, por kjo mund të jetë arsye pse po dështon të krijosh shtatzëni. Nëse analizat spermografike pasqyrojnë gjendje të mirë spermogjenesh te ti dhe burri, atëherë ka mundësi që ekziston një arsye subjektive që është pengesë e vogël për shtatzëni.

E para, duhet ta lirosht kokën nga nervozizmi e stresi dhe ta racional-

izosh sjelljen konform nevojave tua, si e vetmja mënyrë që ta gëzosh prehrin tënd.

A është mëkat të festohet ditëlindja?

Jam 67-vjeçare. A është mëkat të festohet ditëlindja, sepse kam dëgjuar se nuk duhet festuar ditëlindjen?

Të lutem, një sqarim...

Përgjigje:

Nuk kam lexuar askund se është e ndaluar të festohet ditëlindja. Festimi i ditëlindjes është normale të kremtohet, me një festim të mundësive familjare. Sidoqoftë, te ne fliten shumë gjëra dhe detaje që dikush i thotë me bindjet e veta laike dhe një gjë e tillë, pastaj, bëhet si diçka kuranore... Për shembull, prindërit dhe të dashurit tanë familjarë, që kanë vdekur dhe pushojnë në ahiret, kanë nevojë të kujtohen nga të gjallët.

Me cilën do të martohet djali im?

Përsëhendetje, jam nënë, jetoj në Zvicër. Kam probleme me djalin tim, i cili e dashuron një zonjë që ka fëmijë dhe kam frikë se do të martohet me të.

I ka pasur dy të dashura, por i ka lënë për zonjën e martuar!

Ajo ka pasur probleme me burrë, e im bir jeton me të!

Jam në hall me këtë problem, prandaj dua të di me cilën do të martohet djali im?

“Pa shifër”

Përgjigje:

Shoh se ai nuk do bëhet rehat me asnjë vajzë, pos me atë grua... Ajo është disa vjet më e vjetër dhe di ta përvetësojë djalin. Prandaj, frika jote si nënë është e arsyeshme... Sidoqoftë, nuk shoh se do të martohen, por nja tre vjet do të jetojë me të.

Pse jam e padisponuar?

Jam zonjë, 40-vjeçare. I kam tre fëmijë. Nuk jam për momentin duke punuar, edhe pse e kam kryer fakultetin. Andaj, kohëve të fundit po ndihem keq, e padisponuar!

Çka po ndodh me mua? Gjithash-tu, më duket se po rrëshqas kah depresioni!

“Errësira”

Përgjigje:

Kjo që ke treguar ka të bëjë me degradimin e aktivitetit tënd fizik dhe me ndjenjën se ke mbetur pa vlera dinamike. Dhe, nëse mendon kështu, bën gabimin të madh. Ti ke krijuar familje dhe fëmijët janë në studime. E, një gjë e tillë do të ishte një stimulues shpirtëror për ty...

Por, ka edhe diçka që i ka shërbyer kësaj gjendjeje, sepse në vendin ku ke punuar ka qenë i adhuruari yt, të cilin është mësuar syri ta sheh çdo ditë.

E, kjo mungesë tani ka bërë që t’u mungojë diçka e shumëçka dhe krejt kjo është si një re e mbushur shi, por që shkarkohet mbi tokë përmes stuhisë dhe breshrit... Andaj, mos i bë shumë pyetje vetes, sepse rrugën e ke të qartë kah duhet të shkosh...

Nuk po më japin drejtësi në gjyq?

Jam grua e ve. I kam tre fëmijë, prej të cilëve dy janë në Prishtinë. Burri më ka vdekur para dhjetë vjetësh. Ai i ka katër vëllezër.

Problemi është se nuk po ma japin pronën që i ka takuar burrit! E kam hapur rastin në gjyq, por as gjyqi nuk ma ka njohur të drejtën e pronësisë!

“Pa shifër”

Përgjigje:

Timuri ishte pushtet në kohën e Nas-tradininit. Dhe, duke e ditur hoxhën për të mençur, i tha:

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

“Hoxhë, nëse t’i ofrojë 100 lira, në një anë, dhe drejtësinë, në anën tjetër, cilën do e marrësh?”. Nasradini i tha:

“I marr 100 lira!”

Timuri ia ktheu:

“Unë mendova se do e merrje drejtësinë!”

Hoxha ia ktheu:

“Jo, zotëri Timur, drejtësia nuk më duhet, sepse më shumë kam nevojë për lira!”

A e kam fat personin që e dua?

Jam një vajzë nga Peja, 30-vjeçare. Jam në lidhje me një person nga Maqedonia, më i vjetër se unë. A do ta kem fat, edhe pse ai e ka një vajzë?

“Blerina”

Përgjigje:

Ai ka grua, ka edhe vajzë! Por, e ka edhe një fëmijë tjetër me gruan e parë.

Andaj, të këshilloj të largohesh sa më parë prej tij, sepse nuk ke hajr nga ai...

Si ta rikthej besimin e tij?

Jam një vajzë nga Klina. Kam qenë në lidhje me një djalë 7 vjet, por para pak ditësh na ka ndodhur një keqkuptim, andaj ka ikur prej meje...

Jam e pikëlluar dhe po vuaj shumë, sepse më kishte premtuar fejesë!

“E pikëlluara”

Përgjigje:

Nuk ka ndodhur rastësisht. Një javë para këtij skandali ju keni pasur përllarje, sepse të ka parë me dikë tjetër!

Nuk preferoj ta ktheni lidhjen...



SHERWOOD

Resorts and Hotels

**SHERWOOD
EXCLUSIVE KEMER**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
EXCLUSIVE LARA**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
DREAMS RESORT**
BELEK / ANTALYA

**TUI BLUE
BELEK**
BELEK / ANTALYA

**SHERWOOD
GREENWOOD RESORT**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
SUITES RESORT**
LARA / ANTALYA

www.sherwoodhotels.com.tr
+90 444 88 07